



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.556/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.12.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të KVO lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Selami” shpk në procedurën e prokurimit “*E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-65287-07-13-2020, me objekt Loti XIV “*Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga "U. Cerenecit - Klenjë,Trebisht-Dogane, Qaf Bualli-Kraste, Kthesa Lapidari-Lis,K/Rrugen Kombetare-Ulez"*, me fond limit të marveshjes kuader 171.954.454 (njëqind e shtatëdhjetë e një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 28.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues:

“Selami” shpk
Lagjia “Nazmi Rushiti”, Rruga Tercilio Kardinali, Kati II ndërtesa e quajtur Hotel Veri Peshkopi.

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Rrugor Shqiptar
“Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”,

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.07.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-65287-07-13-2020, me objekt Loti XIV “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga "U. Cerenecit - Klenjë,Trebisht-Dogane, Qaf Bualli-Kraste, Kthesa Lapidari-Lis,K/Rrugen Kombetare-Ulez", me fond limit të marveshjes kuader 171.954.454 (njqind e shtatedhjetë e nje milion e nenteqind e pesedhjetë e kater mije e katerqind e pesedhjetë e kater) lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 28.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP më shkresën nr. 9067/1 datë 25.11.2020 si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se në datën 05.08.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit). Në këtë fazë kanë marrë pjesë operatorët si më poshtë.

- 6D Plan	I skualifikuar
- Udha	I kualifikuar
- Pe-Vla-Ku	I skualifikuar
- Euro Alb	I skualifikuar
- Selami	I kualifikuar
- Beqiri&Rafin Company	I skualifikuar
- Alko Impex General Construction	I kualifikuar

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se pas mbylljes së fazës së parë dhe në përfundim të afateve të ankimit autoriteti kontraktor më datë 09.09.2020 me shkresën nr.4758/19 nëpërmjet sistemit elektronik ka drejtuar tek operatorët ekonomikë ftesën për ofertë. Data e përcaktuar për hapjen e ofertave është data 28.09.2020 ora 16:00. Operatorët që i janë përgjigjur ftesës për dorëzimin e ofertës ekonomike janë:

1. “Udha” shpk	153,228,667	lekë pa TVSH
2. “Alko Impex General Construction” shpk	166,994,068.26	lekë pa TVSH
3. “Selami”shpk	97,910,798	lekë pa TVSH

Në datën 28.09.2020 është zhvilluar faza e dorëzimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës.

II.4. Në datën 26.10.2020 KVO-ja përfundoi vlerësimin në pikë të operatorëve ekonomikë si më poshtë:

1. OE Udha shpk

Anëtar i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin	Pikët përvoja në punë e kompanisë	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total cilësi
1	153,228,667	38	16	18	72
2	153,228,667	38	16	18	72
3	153,228,667	38	16	18	72

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 72 pikë.

2. BOE “Alko Impex General Construction& Alko Impex Construction

Anëtar i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin	Pikët përvoja në punë e kompanisë	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total cilësi
1	166,994,068.26	35	18	16	69
2	166,994,068.26	35	18	16	69
3	166,994,068.26	38	18	16	72

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 70 pikë.

3. Për BOE Selami&England

Anëtar i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin	Pikët përvoja në punë e kompanisë	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total cilësi
1	97,910,798	60	18	18	96
2	97,910,798	60	18	18	96
3	97,910,798	60	18	18	96

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mestare 96 pikë.

“Për BOE Selami &England shpk oferta ekonomike rezulton anomalisht e ulët. KVO kërkoj analizë cmimi për ofertën e paraqitur.

KVO gjykon se oferta e Operatorit ekonomik SELAMI per Lot 14, me një zbritje prej 43.07 % , bazuar ne llogaritjet edhe me operatoret e tjere, sipas klauzoles 5.3 te DST rezulton si oferte

anomalisht e ulët. Gjithashtu paragrafi i fundit i kësaj klauzole cilëson : “Në rastin kur kriter vlerësimi është përzgjedhur oferta ekonomike më e favorshme, do të verifikohet nëse ofertat janë anomalisht të ulëta vetëm nëse oferta e klasifikuar me pikët më të larta e ka ofertën ekonomike me vlerën më të ulët”. Të ndodhur me këto kushte, duke qënë se ai figuroni me ofertën ekonomike më të ulët, ne me emailin e datës 09.10.2020, I kemi kërkuar sqarime lidhur me llogaritjen e ofertës, dhe konkretisht analizat e llogaritura nga ana tije mbi bazën e të cilave ka hartuar ofertën. Bazuar në përgjigjen e tij të datës 12.10.2020 mbasi studiuam materialin “Relacionin argumentues , në mbështetje të ofertës së dhënë për realizimin e objektit “ Mirëmbajtje rutinë e dimërore me performancë akset : Ura e Çerenecit – Klenjë, Qafë Bualli – Krastë, K/Ulëz – Ulëz, Ura e Matit – Lis, Trebisht – Doganë, 62.32 km”, sqarojmë si më poshtë vijon : Ne relacionin e tij Operatori SELAMI sqaroni se shoqëria Selami sh.p.k. disponon makineri, mjete dhe te drejta shfrytëzimi si me poshte: → Linjë të përpunimit të inerteve → Karrierë e gurit dhe çakullit në Strikçan → Fabrika e asfaltit → Nyje e betonit → Mjete ne pronësi, Keto mjete dhe te drejta te fituara nga shoqëria prezumohet se krijojnë një avantazh kundrejt operatoreve te tjere por ne relacionin e tij nuk paraqet asnjë analizë te kostos mbi efektin qe keto avantazhe sjellin ne ofertën e tij. Nga shqyrtimi i relacionit rezulton se zbritja e punimeve është shtrire edhe ne zërat e sinjalistikës në masën 27 deri 41.6 %, për të cilat asetet në pronësi te tij nuk ndikojnë. Po kështu edhe tek mirëmbajtja rutine, konstatojmë zbritje që shkojnë deri ne 50%, për zërat që nuk kanë fare lidhje me asetet që shoqëria disponon, nga ato cilat vecojmë zërat e mëposhtëm: - Riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikës horizontale në zbritje 48.55 % - Riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikës vertikale dhe paisjeve me një zbritje në masën 49.97 % - Mirëmbajtja rutinë e veprave të artit, që janë shumë të rëndësishme vecanërisht urat, zbritja prej 50.88%. Zbritja e elementëve të sinjalistikës dhe sigurisë rrugore në punimet e rehabilitimit dhe ato rutinë ndikon drejteperdrejte ne moskryerjen e punimeve të përmirësimit të sigurisë, të cilat sjellin pasoja në rritjen e numrit te aksidenteve rrugore me pasoja te renda per jeten e njerezve.. Konkluzion : Bazuar sa me siper si dhe ne qendrimin e mbajtur edhe nga KPP dhe ne direktiven 2014 te Bashkimit European dhe Organizates Europiane per Bashkepunim Ekonomik, rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur analizen ekonomike të metodës së ndërtimit dhe të shërbimeve , zgjidhjet teknike që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve Zoterimi i mjeteve dhe te drejtes se shfrytëzimit nga ana e operatorit ekonomik nuk perben kusht favorizues per sa kohe qe operatori nuk argumenton diferencen e cmimit qe do te pefitoje nga ky “avantazh” bazuar ne parimet e kosto-eficences c`ka mbart ne vetvete riskun e cilesise, qe nenkupton se mallrat ose shërbimet e ofruara do të jenë të një cilësie më të ulët se ato te percaktuara ne kushtet e kontratës. Nga analiza e ofertes nuk jane paraqitur prova shkresore në lidhje zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, rritjen dhe indeksimin e pages per periudhen e kontrates, shtimin/permiresimin e mekanikes, efektet ekonomike te inflacionit, mbrojtjen e mjedisit etj. Paraqitja e një oferte anomalisht të ulët është rezultat i mospërpunimit me kërkesat e detyrueshme ligjore që kanë të bëjnë me të drejtën sociale, të punës apo të mjedisit Pavaresisht natyres se vecante te shërbimit Autoriteti Kontraktor nuk mund te pranoje nje oferte bazuar ne gjykimin dhe vleresimin subjektiv te Operatorit Ekonomik duke anashkaluar kërkesat teknike te percaktuara ne dokumentat e tenderit. Ne keto kushte Autoriteti kontraktor vlereson se oferta e Operatorit Ekonomik

SELSMI sh.p.k. duhet te refuzohet me arsyetimin se oferta permбан risk te larte per mospermbushjen e detyrimeve kontraktore.”

- Renditja përfundimtare e operatorëve ekonomikë do të jetë:

Nr.	Operatori ekonomik	Pikë
1	Udha	72
2	Alko-Impex General Construction & Alko Impex Construction	70

II.5. Në datën 30.10.2020 operatori ekonomik “Selami” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, në mënyrë të përmbledhur me pretendimet si më poshtë:

- Ne e kundërshtojmë këtë konkluzion refuzim tuajin me këto argumenta:
- Kjo procedurë objekti i këtij ankimi ishte një procedurë me 2 faza. Faza e parë kualifikimi ligjor dhe Faza e dytë konkurrim për ofertën financiare. Sipas DT kriter vlerësimi është përzgjedhur oferta ekonomike më e favorshme.
- Së dyti Në konkluzionet e bëra nga AK-ja konstatohet se ato pjesërisht u referohen argumentave të bëra nga ana jonë në relacionin argumentues por nuk kanë trajtuar dhe marrë në konsideratë analizat teknike të cmimeve që ne kemi bërë (pas kërkesë tuaj për të argumentuar vlerën apo ofertën tonë të ulët). Pra bashkëlidhur këtij relacioni gjendej dhe analiza teknike e detajuar dhe e argumentuar detajisht zë për zë pune për cmimin e ofertuar nga ana jonë, dhe kjo sigurisht duke marrë në konsideratë normalisht dhe standartet ligjore si për cilësinë e materialeve ashtu edhe për sigurinë dhe shëndetin në punëpër sigurimet shoqërore për punonjësit standartet mjedisore.

Etj.

Në këtë zbërthim analitik ne kemi dhënë argumenta që në ofertën tonë me cmimin e ofruar ne jemi në gjëndje dhe në përmbushim pa dëmtuar cilësinë dhe zërat e sinjalistikës horizontale dhe zërin riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikës vertikale dhe pajisjeve dhe po ashtu dhe zëri i mirëmbajtja rutinë e veprave të artit (përfshirë dhe urat).

Përveç sa më sipër avantazhet që ne kemi (të cilat janë evidentuar edhe në konkluzionet tuaja me mjetet e makineritë në pronësi dhe asete me të drejta shfrytëzimi si linjë e përpunimit të inerteve, karrierë e gurit dhe cakëllit në Strikcan; Fabrika e asfaltit; Nyjë betonit; mjete në pronësi; është e vetkuptueshme që këto janë garancia më e madhe për të justifikuar koston e reduktuar në zërat e cmimeve ku këto ndikojnë dukshëm dhe drejtpërdrejtë dhe që në fakt këto përbëjnë bazën dhe % më të madhe të volumit të punimeve apo % më të madhe të vlerës së kontratës apo objekti nëfjalë. Pra kjo argumenton që diferenca e cmimit që ne përfitojmë nga gjëndje e aseteve makinerive etj justifikon zbatimin e parimin të kosto eficemcës duke garantuar cilësinë e kërkuar në kushtet e kontratës dhe standartet respektive dmth kursimi nga këto avantazhe prej

aseteve makinerive bazës materiale sasia e kripës gjëndje etj, dhe të drejtave që ne posedojmë mbulon koston e reduktuar të zërave që ju dyshoni në përmbushje të tyre që vërtet janë të rëndësishme (dhe kështu janë konsideruar dhe konsiderohen edhe nga ana jonë edhe pse nuk zënë peshën më të madhe në vlerën totale të ofertës kontratës. Nëse ak ishte i paqartë në argumentat relacionin dhe analizat tona shpjeguese duhet të na kërkoonte sqarime shtesë dhe të mo kalonte në konkluzione subjektive aluduese.[...]. Lidhur me pretendimin se KVO-së se nuk janë paraqitur prova shkresore që lidhen me mbrojtjen në punë sqarojmëse: Të gjitha këto aludime të cituara nga konkluzionet e KVO-së nuk kan të bëjnë më thelbin e problemit dhe natyrën e objektit të kontratës sigurimi dhe paga e punonjësve janë elementare për cdo subjekt nuk kan ëtë bëjnë më mirëmbajtjen dimërore dhe kontrollohen periodikisht nga organet shtetërore, dhe ne nuk kemi pasur problem në këtë drejtim. Sa më siëpr kërkojmë nga ana juaj anulimin evendimit të KVO-së rivlerësimin e ofertave kualifikimin tonë si ofertë e rregullt ligjore [...]

II.6. Në datën 06.11.2020 nëpërmjet shkresës me nr.8325/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 12.11.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr. 9067/1 prot., datë 25.11.2020, protokolluar me tonën me shkresën nr.1481/2 datë 27.11.2020 me objekt “*Dërgim informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues “Selami” shpk & “England” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se “*Oferta juaj ekonomike refuzohet nga komisioni i vlerësimit të ofertave pasi argumentimi juaj mbi ofertën anomalisht të ulet nuk përmbush dispozitat ligjore të parashikuara në neniin 56 të ligjit për prokurimin publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP me shkresën nr. 9067/1 protokollin datë 25.11.2020 protokolluar me tonën me nr.1481/3 prot datë 27.11.2020 me objekt “Loti XIV “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga "U. Cerenecit - Klenjë,Trebisht-Dogane, Qaf Bualli-Kraste, Kthesa Lapidari-Lis,K/Rrugen Kombetare-Ulez", me fond limit të marveshjes kuader 171.954.454 (njëqind e shtatëdhjetë e një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa tvsh”, rezulton se është dërguar gjithashtu edhe arsyetimi i ofertës anomalisht të ulët nga ana e operatorit ekonomik.

Konkretisht, rezulton se është dorëzuar dokumentacioni me titull “Relacioni Agrumentues! Në mbështetje të Ofertës së dhënë për realizimin e objektit: *Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga "U. Cerenecit - Klenjë,Trebisht-Dogane"*. Referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton se është dorëzua një relacion narrativ me dy faqe, si edhe një analizë mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike në 7 faqe. Konkretisht, operatori ekonomik ka arsyetuar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

- *Prej vitesh me aktivitet të tillë kemi krijuar eksperiencë të konsiderueshme në përmbushjen e të gjitha detyrimeve dhe elementëve të këtyre tip kontratash si dhe kemi blerë vit pas viti makineri dhe asete të konsiderueshme për menaxhimin dhe garantimin e besueshmërisë dhe suksesit për këto kontrata. Ne disponojmë në pronësi një linjë të përpunimit të inerteve ku përpunojmë volume masive vjetore të cakëllit , granilit, stabilizantit rërës etj. Kemi karrierën tonë të gurit dhe cakëllit në strickan. Pranë nyjes së inerteve gjendet edhe fabrika e asfaltit si dhe nyja e betonit të gjitha në pronësi të tonë. Disponojmë 30 automjete dhe makineri. Kemi rreth 109 punonjës.*

III.1.2. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...].”

III.1.3. Në nenin 66 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë

ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogarit. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni I vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]”

III.1.4. Në seksionin II “Udhëzime për operatorët ekonomikë” të dokumenteve të procedurës së prokurimit, seksioni 5 “Vlerësimi i Ofertave”, nënparagrafi 5.3.2. parashikohet se: “Në rastin kur kriter vlerësimi është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme, do të verifikohet nëse ofertat janë anomalisht të ulëta vetëm nëse oferta e klasifikuar me pikët më të larta e ka ofertën ekonomike me vlerën më të ulët.”

III.1.5. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangjen e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër

të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore. të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlogaritjes të parashikuar në ligj.

III.1.6. Referuar ofertës së operatorit ekonomik të dorëzuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi, si edhe në respect të nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, të nenit 66 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar si edhe Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë të dokumenteve të procedurës së prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se oferta e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se vërtet ligjënsësi ka lejuar paraqitjen e ofertave anomalisht të ulta por në cdo rast operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në cdo rast prova bindëse për autoritetin kontraktor se nuk ka asnjë rezik për realizimin me sukses të kontratës me cmimin e ofertuar dhe se në këtë cmim janë të përfshira të gjithë elementët e koston të nevojshme dhe të detyrueshme për tu mbuluar. Në kuptim të ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht nenit 56 të tij, në justifikimin e ofertave anomalisht të ulëta, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se përmbushin 4 kushtet kumulative ku tre prej të cilave lidhen drejtpërdrejtë me metodën ekonomike të ndërtimit të ofertës së dorëzuar si edhe kushtet favorizuese që kanë operatorët ekonomikë të cilat kanë lejuar këtë të fundit, si edhe të ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi të paraqesin një ofertë e cila është anomalisht e ulët sipas formulës së përcaktuar si më sipër sqaruar.

Gjithashtu, referuar metodës së ndërtimit të ofertës ekonomikë dhe kushteve favorizues të deklaruar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion ose provë që të dëshmojë ndonjë kusht favorizues për asnjë nga bazën materiale të nevojshme për realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes, ashtu sic është parashikuar edhe në preventivin e shërbimit si *Punime Rehabilitimi*, ku ndër të tjerat përfshihet edhe punime të sinjalistikës rrugore, me Tabele katrore normal me A=60 cope 40, Tabela trekendore normal me A = 90 cope 135, Tabele rrethi "detyrim" normal me D = 60 cope 35, Tabela tetekendore normal me A-B, 90- 30 cope 20, Pervijues normal anesor rruge me dy sense (e kuqe + e bardhe) cope 10, Pervijues modulare te kthesave (teke) cope 10, Pervijues

modulare te kthesave (çift) cope 10, Pervijues kthese e ngushte ose e forte (ne forme T) cope 10, V tabela rrugore treguese 150x40cm cope 8, FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm cope 20, Parapet i njeanshem per beton (ø 60) + aksesoret (ura) ml 20, Guardrail- H1 anesore me 2 valz.e ne 1 ane , Ë3 + aksesoret (rruge) ml 2100”. Në lidhje me zërat e mësipërm të punimeve, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes nuk është paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, në kuptim të nenit 56 të pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar.

III.1.7. Gjithashtu në lidhje me zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, nga shqyrtimi i relacionit të argumentimit të ofertës anomalisht të ulët, rezulton se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë për zërat e punimeve “Skarifikim shtresë asfalti me makineri”, Mbushje me Ccakëll pas mureve”, “Pastrim i kanaleve dhe kunetave”, “Pastrim i tombinove ekzistuese rrethore dhe katrore” “Mbushja dhe nivelimi i bankinave”, “Pastrim i vegjetacionit” “Pastrim i karrexhatës nga aluvionet dhe materialet e tjera” “Riparim i gropave të asfaltit” “Mbushje dhe profilim nënshtresave në rrugët me asfalt”, “Mirëmbajtje rutinë e veprave të artit” gjithashtu edhe në punimet e Tabelës A/2” është deklaruar në seksionin e “Punëtorisë”, Ccmimi për orë pune 125 lekë. Në nenin 111, pika 1, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Paga nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave “ III.1.4. Në V.K.M nr. 809 datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, parashikohet se: “1. Paga bazë minimale mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendës ose i huaj, të jetë 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë. 2. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. 3. **Paga bazë minimale orare të jetë 149 (njëqind e dyzet e nëntë) lekë.** Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomik ankimes, në analizën e cmimeve të paraqitur në procedurën e prokurimit objekt ankimi, ka parashikuar se paga bazë orare për punëtorët është 125 lekë/orë, e cila është nën minimumin ligjor të lejuar dhe në kundërshtim me përcaktimet e V.K.M nr. 809 datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, e cila parashikon në mënyrë eksplicite se paga minimale orare nuk mund të jetë nën 149 lekë. Komisioni thekson se, respektimi i legjislacionit në fuqi lidhur me pagat e punonjësve nga ana e operatorëve ekonomik, siguron autoritetin kontraktor, jo vetëm për realizimin e punimeve, por edhe për realizimin e tyre sipas standarteve të kërkuara në cilësi dhe volum dhe me çmimin konkurses të ofertuar.

Në rastin konkret KPP gjykon se operatori ekonomik ka përmbushur vetëm njërin nga katër kushtet kumulative e konkretisht atë të origjinalitetit të shërbimeve në kushtet kur është prodhues i sistemit por nuk ka marrë parasysh elementë të tjerë të ofetës shumë të rëndësishme sikundër është analiza e detajuar e kostos me të gjithë zërat e shërbimeve të ofruar.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se një parashikim i tillë gjen mbështetje edhe në Direktivën 24/2014 KE “Për prokurimin publik”, ku në nenin 69 të saj, parashikohen edhe kushtet për pranimin e ofertës anomalisht të ulët, në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik. Konkretnisht, në nenin 69 të saj parashikohet se: “Kur autoritetet kontraktore vërejnë se ofertat në lidhje me punët, furnizimet ose shërbimet janë anomalisht të ulëta, u kërkojnë operatorëve ekonomikë që të shpjegojnë çmimin ose kostot e propozuara në ofertë. Shpjegimet e përmendura në paragrafin 1, jepen veçanërisht për:

- (a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
- (b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- (c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- (d) pajtueshmërinë me detyrimet e përmendura në nenin 18, paragrafi 2;
- (e) pajtueshmërinë me detyrimet e përmendura në nenin 71;
- (f) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët, duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Selami” shpk për procedurën e prokurimit, *E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*, me Nr. REF-65287-07-13-2020, me objekt Loti XIV “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga ”U. Cerenecit - Klenjë, Trebisht-Dogane, Qaf Bualli-Kraste, Kthesa Lapidari-Lis, K/Rrugen Kombetare-Ulez”, me fond limit të marveshjes kuader 171.954.454 (njëqind e shtatëdhjetë e një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 28.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedures së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1481 Protokoli, Datë 12.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri